



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 413/6 prot.

Tiranë, më 02.10.2020

**VENDIM**  
**Nr.109, datë 02.10.2020**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 71, DATË 17.07.2020, NË**  
**INSTITUCIONIN BASHKIA VAU DEJËS**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 71, dt. 17.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit të Bashkisë Vau Dejës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar

procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë së Vau Dejës, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 2776/1 prot., datë 04.06.2020, ka raportuar se, megjithëse ka plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, vazhdon ende të jetë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësja \*\*\*\*\* (datëlindja 30.04.1959), në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK”, e cila e ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 30.04.2020.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë së Vau Dejës, vendimin paralajmërues me Nr. 71, dt. 17.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit të Bashkisë Vau Dejës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia e Vau Dejës, me shkresën nr.4219/1 prot., datë 22.07.2020, “Kthim përgjigje”, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur të Bashkisë Vau Dejës, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësen \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK”.
2. Pozicioni respektive i punës, u shpall si pozicion i lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

- 1.** Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 71, dt. 17.07.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia e Vau të Dejës, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Bashkisë Vau Dejës.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Vau Dejës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**